

# Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

## Prill, 2018

**Tiranë, më 23 Maj 2018:** Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Prill 2018, është 781.404. Krahasuar me Prill 2017, ky tregues rezulton me rritje 2,2 %.


Në Prill 2018, numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 351.610. Krahasuar me Prill 2017, ky numër është ulur me 2,2 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në katërmujorin e parë e 2018 është 1.028.498, duke u rritur me 7,0 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Në Prill 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe me 41,9 %, ndërsa uljen më të madhe e kanë patur shtetasit nga Zvicra me 25,2 %.

Në katërmujorin e parë 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe 33,0 % .

**Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri**



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë muajit Prill 2018, janë 806.412, duke shënuar një rritje me 5,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Prill 2018, është 451.147. Krahasuar me Prill 2017, ky numër është rritur 5,1 %. Numri i shtetasve të huaj të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Prill 2018, është 355.265. Krahasuar me Prill 2018, ky numër është rritur 5,2 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në katërmujorin parë 2018, është 1.563.003, duke u rritur 5,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj**

Periudha	Prill 17	Prill 18	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Prill 17	Janar- Prill 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
<b>Hyrje gjithsej</b>	<b>764.485</b>	<b>781.404</b>	2,2	<b>2.281.912</b>	<b>2.487.699</b>	9,0
Shqiptarë	405.033	429.794	6,1	1.320.520	1.459.201	10,5
Të Huaj	359.452	351.610	-2,2	961.392	1.028.498	7,0
<b>Dalje gjithsej</b>	<b>766.779</b>	<b>806.412</b>	5,2	<b>2.440.395</b>	<b>2.626.812</b>	7,6
Shqiptarë	429.126	451.147	5,1	1.475.239	1.563.003	5,9
Të Huaj	337.653	355.265	5,2	965.156	1.063.809	10,2

**Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj**

Shtetet	Prill 17	Prill 18	Ndryshim vjetor (%)	Janar- Prill 17	Janar- Prill 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Kosovë	125.908	121.078	-3,8	327.607	346.997	5,9
Maqedoni	49.380	51.878	5,1	144.685	150.054	3,7
Greqi	43.697	33.816	-22,6	128.273	132.535	3,3
Itali	25.580	23.760	-7,1	75.183	79.423	5,6
Angli	8.665	6.730	-22,3	20.325	19.997	-1,6
Mali i zi	33.049	34.028	3,0	107.409	109.330	1,8
Poloni	1.735	2.462	41,9	2.767	3.681	33,0
SHBA	5.714	5.349	-6,4	15.064	15.495	2,9
Gjermani	8.812	7.482	-15,1	16.786	16.956	1,0
Zvicër	4.552	3.403	-25,2	8.133	7.261	-10,7
Të tjera	52.360	61.624	17,7	115.160	146.769	27,4
<b>Gjithsej</b>	<b>359.452</b>	<b>351.610</b>	-2,2	<b>961.392</b>	<b>1.028.498</b>	7,0

**Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**

Periudha	Prill 17	Prill 18	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Prill 17	Janar- Prill 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
<b>Hyrije Shtetas të Huaj</b>	359.452	351.610	-2,2	961.392	1.028.498	7,0
<b>I. Personale</b>	353.374	344.304	-2,6	943.201	1.005.812	6,6
1. Pushime	119.921	71.062	-40,7	234.779	168.339	-28,3
2. Vizitë në miq e të afërm	1.212	1.016	-16,2	3.414	3.986	16,8
3. Vizitë ditore	6.868	22.451	226,9	24.069	44.022	82,9
4. Trajtim shëndetësor	42	28	-33,3	222	94	-57,7
5. Qëllime fetare	52	130	150,0	184	259	40,8
6. Vizitorë të tjerë	206.163	232.979	13,0	636.013	742.031	16,7
7. Udhëtarë transit	19.116	16.638	-13,0	44.520	47.081	5,8
<b>II. Biznes dhe profesionale</b>	6.078	7.306	20,2	18.191	22.686	24,7

**Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit**

Periudha	Hyrije gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Prill 2017	97.096	42.271	625.118	93.454	43.802	629.523
Prill 2018	108.449	29.685	643.270	106.039	31.340	669.033
Ndryshimi vjetor (%)	11,7	-29,8	2,9	13,5	-28,5	6,3
Janar-Prill 2017	344.940	111.311	1.825.661	353.551	149.825	1.937.019
Janar-Prill 2018	384.366	96.338	2.006.995	391.073	119.201	2.116.538
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	11,4	-13,5	9,9	10,6	-20,4	9,3

# Metodologji

## Përkufizime

**Vizitorë:** Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

**Hyrjet:** Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

**Daljet :** Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

*Kategoria e biznesit* përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/reth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>